



AKT THEMELIMI & STATUT

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Njësia Administrative Nr. 3, Rr. "BAJRAM ÇELA", Nd. 6, Hyrja 14, Kati 1, Ap.2,
Nr.Postar 1005; Tiranë - Albania;
tm@deco2.al

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1.1 Sot, më 01.10.2019, unë themeluesi, kam krijuar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emër "DECO2STUDIO" SHPK.
- 1.2 Themeluesi i shoqërisë është:
Z. **Tomorr Menzelxhiu**, shtetas i Maqedonisë së Veriut, identifikuar me Nr. 0908988432034 dhe me pashaportë Nr. K1159587, atësia Beqir, i datëlindjes 09/08/1988, lindur në Prishtinë/Republika e Kosovës dhe banues në Tiranë/Shqipëri, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

Neni 2

Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Studio projektimi, supervision dhe kolaudimi: Masterplan-studime e plane racionale urbanistike, plan rregullues të përgjithshëm për qendra të banuara-qytete, studime pjesore urbanistike, projektim objekte civile-industrial-turistike deri 5 kate dhe mbi 5 kate, projektim objekte sportive, projektim interiere, vepra arti (pikturë, skulpturë, etj), projektim pejsazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërt, lulishte e parqe, objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton/arme deri në 5 kate dhe mbi 5 kate – objekt me skelet metalik, objekt me shkalle të lartë vështiresie b/arme, metalike troje dhe shpate me qëndrueshmeri të ulët, instalime h/sanitare, instalime termoteknike-ventilim-kondicionim, linja e rrjete elektrike-telefonike-radiotelefoni-citofoni-sisteme alarmi-televizive për objekte civile, industriale,turistike, sisteme komplekse të telekomunikacionit, sisteme të furnizimit me gaz, diga , galeri, tunele, furnizim me ujë-kolektor shkarkimi, ujesjelles kanalizime urbane e rurale, vepra ujitje-kullimi-impjante vaditëse diga deri në 10 m-damba, vepra të trajtimit të ujit, vepra hidroteknike: marrje uji, shkarkimi, kulla ekuilibri, porte e pontile, vepra naftesjellese-gazsjelles-vajsjelles, rrugë auto kategori e I deri V, shtresa rrugore e sistemim asfaltim, autostrada, pista, aeroporte, heliporte, hekurudha e degezime hekurudhore, ura dhe vepra arti mbi 10 cm, estakada, ura metalike dhe të varura, tunele rrugore e hekurudhore, centrale hidraulike dhe termike, impiante të prodhimit dhe shpërndarjes të energjisë elektrike-diellore-ere, nënstacione elektrike, primare e sekondare – linja të tensionit të lartë, kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët dhe të mesëm, sinjalizime në rrugë auto kategori I deri V, autostrada dhe degezime me hekurudhën, sinjalizime në aeroporte dhe heliporte.

Shoqëri ndertimi: punime gërmimi, objekte civile-industrial-turistike deri 5 kate dhe mbi 5 kate objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton/arme deri në 5 kate dhe mbi 5 kate-objekt me skelet metalik, objekt me shkalle të lartë vështiresie

Njësia Administrative Nr. 3, Rr. "BAJRAM ÇELA", Nd. 6, Hyrja 14, Kati 1, Ap.2,Nr.Postar 1005;
Tiranë – Albania;

b/arme, metalike, troje dhe shpate me qëndrueshmeri te ulet, instalime h/sanitare, instalime termoteknike-ventilim-kondicionim, linja e rrjete elektrike-telefonike-radiotelefoni-citofoni-sisteme alarmi-televizive për objekte civile, industrial, turistike sisteme komplekse te telekomunikacionit, sisteme te furnizimit me gaz, diga, galeri, tunele, furnizim me uje-kolektor shkarkimi, ujësjelles kanalizime urbane e rurale, vepra ujitje-kullimi-impjante vaditëse-diga deri ne 10 m- damba, vepra të trajtimit te ujit, vepra hidroteknike: marrje uji, shkarkimi, kulla ekuilibri, porte e pontile, vepra naftesjellese-gazsjelles-vajsjelles, rruge auto kategori e I deri V, shtresa rrugore e sistemim asfaltim, autostrada, pista, aeroporte, helioporte, hekurudha e degezime hekurudhore, ura dhe vepra arti mbi 10 cm, estakada, ura metalike dhe te varura, tunele rrugore e hekurudhore, centrale hidraulike dhe termike, impiante te prodhimit dhe shperndarjes të energjisë elektrike-diellore-ere, nënstacione elektrike, primare e sekondare – linja të tensionit të lartë, kabina elektrike të rrjetit shperndares – linja te tensionit të ulët dhe të mesëm, sinjalizime në rrugë auto kategori I deri V, autostrada dhe degëzime me hekurudhën, sinjalizime në aeroporte dhe helioporte.

Ushtrim veprimtarie për shit-blerje materiale ndertimi të vendit dhe importi që përdoren për qëllime ndertimi.

Objekti I veprimtarisë së shoqërisë ne projektim, supervision, kolaudim dhe ndertim bëhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 3 **Kohëzgjatja**

Shoqëria themelohet më 01/10/2019. Ajo do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR.

Neni 4 **Selia**

- 4.1 Shoqëria e ka selinë në: Njësia Administrative Nr. 3, Rr. "BAJRAM ÇELA", Nd. 6, Hyrja 14, Kati 1, Ap.2, Nr.Postar 1005; Tiranë – Albania
- 4.2 Shoqëria mund të ndryshoje selinë e saj, të hape zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brënda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblese së Ortakëve.
- 4.3 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është tm@deco2.al
- 4.4 Numri kontaktit të shoqërisë për qëllime komunikimi është (+355) 686060668

KREU II **KAPITALI**

Neni 5 **Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqindmijë) dhe është i përbërë nga 1 kuotë me vlerë nominale 100.000. Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është:
Ortaku themelues **TOMORR MENZELXHIU** është zotërues i 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njëqindmijë) lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar

Njësia Administrative Nr. 3, Rr. "BAJRAM ÇELA", Nd. 6, Hyrja 14, Kati 1, Ap.2, Nr.Postar 1005;
Tiranë – Albania;

të shoqërisë. Kontributet do të jenë në para dhe do të derdhen në arkën/bankën e shoqërisë pas Biznesit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç";
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë së 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë së 30 për qind të kuotave.

ë rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë së gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë së 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përfashtimi nga e drejta e votes

- 12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjith. merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


Neni 13

Administrimi

Shoqëria do të përfaqësohet ligjërisht nga:

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. **Tomorr Menzelxhiu**, shtetas i Maqedonisë së Veriut, identifikuar me Nr. 0908988432034 dhe me pashaportë Nr. K1159587, atësia Beqir, i datëlindjes 09/08/1988, lindur në Prishtinë/Republika e Kosovës dhe banues në Tiranë/Shqipëri, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

Me nënshkrim:

TOMORR MENZELXHIU 

Administratori do të ushtrojë detyrat e tij sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje në përputhje me ligjin dhe pa kufizime në kompetenca nga data e themelimit.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 14

Kompetencat e administratorit

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratoret janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme në rastet kur:

- a) Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuarve brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- c) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një Administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë:

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve; për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR – EKSPERTET

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë i ngarkuar nga ana e Ortakëve.

Në perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë Ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtes vendimore që ka.

KREU V PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18 Shpërndarja dhe likuidimi

Shpërndarja e ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi - ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa kohë nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", "kodi Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin midis Shoqërisë dhe të tregtarëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAK

Shoqërisë me përgjegjësi të Kufizuar

DECO2STUDIO

TOMORR MENZELXHIU



TOMORR MENZELXHIU